

VENDIM
Nr.665, datë 21.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË
DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA
GJIROKASTËR TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Gjirokastrë të qarkut të Gjirokastrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 13 (trembëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARI I LISTËS PËRFUNDIMTARE PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE

(Mbështetur ne inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Bashkia: Gjirokastrë										
Nr. rend.	Numri i pasurisë sipas VKM	Emertesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi të administrative	Institucioni, enti përdoues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	1025	EP Mali Gjere	Faqe e perroit te Ficos	40/b	P.Prodhues	3.5	LP+DZ	MMPAU	Bashkia	
2	1026	"	Faqe e perroit te Ficos	c	P.Prodhues	4.5	LP+DZ	"	"	
3	1027	"	Faqe e perroit te Ficos	d	P.Prodhues	7.8	LP+DZ	"	"	
4	1028	"	Balta e bardhe	e	P.Prodhues	6.25	LP+DZ	"	"	
5	1029	"	Balta e kuqe	f	P.Prodhues	5	LP+DZ	"	"	
6	1030	"	Balta e bardhe	g	P.Prodhues	11.25	LP+DZ	"	"	
7	1031	"	Granica	43/a	P.Prodhues	3.5	LP+DZ	"	"	
8	1032	"	Blinja	44	P.Prodhues	25.75	Dru zjarri	"	"	
9	1033	"	Shtrunga e gjarperit	45/a	P.Prodhues	15.25	LP+DZ	"	"	
10	1034	"	Faqe e Gerhotit	45b	Bosh	7.75		"	"	
11	1035	"	Gropa e ftohtë	53b	P.Prodhues	11	Dru zjarri	"	"	
12	1036	"	Gropa e ftohtë	c	P.Prodhues	10.5	Dru zjarri	"	"	
13	1037	"	Ferthi	d	P.Prodhues	21.25	Dru zjarri	"	"	

Numrat rendore të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1025-1037	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi